

DRAFTI I
RAPORTIT TE VLERESIMIT TE NDIKIMIT
NE MJEDIS
TE AKTIVITETIT

“Impiant fraksionimi inertesh,prodhim asfalto-betoni,prodhim i tubave te betonit,prodhim i pllakave,bordurave,bloqeve te betonit,shperndarje karburanti dhe autoservis”



Subjekti: “Afrimi” sh.p.k

Vendndodhja: Fshati Borovjan, komuna Kastriot, qarku Diber

Pergatiti materialin: Eko-Studio-Projekt sh.p.k

ADMINISTRATORI: Shkëlzen MADANI

Tirane, 2016

PERMBAJTJA

 Hyrje

 Baza ligjore

1. **PERSHKRIMI I AKTIVITETIT**
2. **PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI**
3. **VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS**
4. **MASAT PER ELEMINIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE**
5. **KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME**

HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme. Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

“Impiant fraksionimi inertesh, prodhim asfalto-betoni, prodhim i tubave te betonit, prodhim i pllakave bordurave, blloqeve te betonit, shperndarje karburanti dhe autoservis”

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 10 266 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*

- VKM nr.419 date 25.6.2014 « *Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja* ».
- Vendim Nr.13, date 04.01.2013 ” *Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis*”.

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

➤ Profili i propozuesit

Subjekti "Afrimi" sh.p.k me numer NIPT-I J66702745H do te ushtroje aktivitetin e impiantit te fraksionimit te inerteve, prodhimit te asfalto-betonit, prodhim i tubave te betonit, prodhim i pllakave, bordurave, blloqeve te betonit, shperndarje karburanti dhe autoservis. Me pergatitjen e dokumentacionit perkates subjekti kerkon te pajiset me Leje Mjedisore te tipit B.

Pershkrimi i qellimit te propozuar

Subjekti "Afrimi" sh.p.k Diber eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e themeluar ne vitin 1994. Ajo ushtron veprimtarine e saj ne fushen e ndertimit si rere, granile, e ndertime rrugore. Linja e inerteve qe do te ndertohet, ndodhet ne afersi te ketij fshati , ne anen e djathte te rruges automobilistiek Peshkopi-Kastriot, shume prane disa objekteve te tjera, te ketij subjekti. Vlera totale e investimit eshte 7000000 lek. Mendohet se per zhvillimin e ketij aktiviteti do te punesohen 10 punetore e specialist te ndryshem. Kapaciteti i prodhimit te inerteve ne kete linje do te jete rreth 1500m³.

Pershkrimi i parametrave kryesore te prodhimit

Pershkrimi i teknologjise se prodhimit

Impianti Thyerje-Fraksionimi-Larje inertesh

Impianti i fraksionimit te inerteve eshte linja e dyte teknologjike e investuar nga kjo shoqeri , e cila e ka filluar ushtrimin e aktivitetit qe ne vitin 1994.

Linja e re qe do te vendoset ne fshatin Borovjan ze nje $S=4000m^2$ dhe per kete do te investohen 7000000 lek. Ky impiant do te ngrihet ne mbeshtetje te shfrytezimit te inerteve te perroit te Gjelagjoshit. Ku do te shfrytezohen prurjet e medha disa vjecare te tij e qe do shfrytezohen, nga ana e subjektit te lartecituar per te prodhuar fraksione te llojeve te ndryshme.

Lendet e para qe perdoren ne procesin e prodhimit jane:

- Rere.....0.5mm
- Granil 1 me dimensione .5-10mm
- Granil 2 me dimensione 10-20mm

Kapaciteti perpunues eshte afersisht $10\text{m}^3/\text{h}$ makinerite jane te paraqitura sipar radhes funksionale te tyre:

- Bunker i pranimit te lendes se pare 20 m^3 qe vjen nga magazine ose direkt nga automjetet qe e sjellin nga furnitoret nga ku merren inertet. Ajo mbushet me kamiona vetshkarkues qe ngjiten nepermjet nje "piacale" te vogel deri tek gryka e saj,
- Nje pajisje ushqyese ne forme shneku (Karrel Mod. AC 60) me permasa te dritares furnizimit $560 \times 2600\text{ mm}$ qe ndodhet e montuar ne fund te bunkerit te furnizimit me lende te pare (Trimozha) per transportierin, vihet ne pune nga nje motor elektrik 5.5 kW ,
- Transportier me rrip gome antiabraziv Mod.NT 60/24 me permasa te transportuesit $600\text{mm} \times 24\text{ m}$ dhe fuqi motorrike 7.5 kW . Lenda e pare nepermjet ketij transportieri kalon nga bunker i furnizimit franto,
- Franto Granulimi Mod .GRC 100 sherben per te thyer kokrrizat e medha nga $20-170\text{ mm}$ te inerteve qe rikthehen nga sita nepermjet transportierit me shirit. Permasat e dritares se furnizimit jane $200-1000\text{ mm}$ ka nje fuqi motorrike 45kW . Frantoja eshte e pajisur edhe me aksesore te tjere metalike te nevojshem,
- Nje pajisje ushqyese me vibrim elektomekanik (Karrel Mod.AV 60) per frantone me permasa $600 \times 600\text{ mm}$ qe vihet ne pune nga dy elektromotorre $0.7 + 0.7\text{ kW}$,
- Transportier me rrip gome antiabraziv Mod.NT 60/24 me permasa te transportuesit $600\text{mm} \times 24\text{m}$ dhe fuqi motorrike 7.5 kW . Lenda inerte e thyer ne copa te vogla nepermjet ketij transportieri kalon nga frantoja ne lavatricen rrotulluese ku behet larja me uje te rrjedhshem,

- Site Vibruese Mod.VV 1553 me larje me 3 tipe sitash koalsiale me permasa 1500 x 1500 mm per dimensione te ndryshme te lendes inerte ,ka nje fuqi motorike 11kW,
- Bunker i vogel me shnek qe mbledh fraksionin e 0-5 mm te reres dhe ushqen transportierin e ketij fraksioni,vihet ne pune me nje motor elektrik me fuqi 2.2kW,
- Rera e imet 0.5 mm kalon nga bunkeri me shnek ne nje lavatrice tjetër te vecante vetem per reren e cila ka kerkesa me te larta teknologjike sepse duhet te jete shume e paster per tu perdorur ne industrine e parafabrikateve te ndertimit,
- Transportier me rrip gome antiabraziv Mod.NT 50/15 me permasa te transportuesit 500 mm x 15m dhe fuqi motorike 3kW.Fraksioni 0.5 mm i reres nepermjet ketij transportieri kalon nga lavatricja e reres dhe dergohet ne sheshin e hapur te depozitimit te produktit te gatshem,+ 2 Transportiera me rrip gome antiabraziv Mod.NT 40/15 me permasa te transportuesit 400 mm x 15 m dhe fuqi motorike 2.2 x 2kW.Fraksionet 5-10 dhe 10-20 mm I reres nepermejet ketij transportieri kalon nga sita vibruese ne sheshin e hapur te depozitimit te produktit te gatshem,
- Transportier me rrip gome antiabraziv Mod.NT 50/13 me permasa te transportuesit 500mm x 13m dhe fuqi motorike 4kW. Fraksioni i trashe i inerteve mbi 20 mm nepermjet ketij transportieri rikthehet nga sita vibruese qe del si mbetje dhe dergohet ne bunkerin e mullirit(silos) me synimin per ta bluar dhe rikthyer perseri ne site,
- Silos 6 m³ qe grumbullon inert mbi 20 mm te rikthyer nga sita me synim per ta bluar ne mullirin me cekica,
- Mulliri me cekic sherben per te thyer kokrrizat me te medha se 20mm te inerteve qe rikthehen nga sita nepermjet transportierit me shirit.permasat e dritares se furnizimit jane 200 x 1000 mm,ka nje fuqi motorike 45kW,
- Transportier me rrip gome antiabraziv Mod.NT 50/13 me permasa te trasportuesit 500mm x 13m deh fuqi motorike 3kW.Materiali inert i thyer qe del nga mulliri nepermjet ketij transportieri kthehet perseri ne sistemin e prodhimit ne pozicionin

per ta rikthyer perseri ne site.Lenda e pare e marre nga magazine e lendeve te para,futet nga piacala ne bunkerin 1 me ane te transportierit 2 ajo kalon nje frantone 3 ku behet thyerja e copave te medha te gurit mbi 20mm.Nga frantoja kalon me transportier ne lavatricen horizontale rrotulluese 4 ne te cilem behet larja e baltes(dhera e argjila)me uje te rrjedhshem.Pastaj nepermjet sitave rrotulluese koaksiale 5 behet ndarja e ne fraksione e reres dhe e granileve.Fraksioni i trashe rikthehet perseri me nje transportier tjetet ne bunkerin 6 te mullirit me cekica 7.Ne mullirin me cekic behet bluarja e copave te inerteve (gureve) me te medha se 20mm dhe me te vogel se materiali qe hyn ne franto.Nga mulliri me cekic materiali i punuar kalon perseri ne sistemin e sitave per fraksionim.Rera e imet 0.5 mm kalon perseri per larje ne lavatricen e reres.Larja e reres eshte kerkese teknologjike e materialeve inerte te cilesise se larte.

Vendshperndarja e karburantit

Skema teknologjike eshte zgjedhur ne funksion te llojeve te karburanteve qe tregtohen, kapacitetit ditor te shperndarjes dhe kushteve konkrete te terrenit.Eshte instaluar nje depozit betoni me kapacitet 100m³ po qe po pregatiten te bejne zevendesimin e depozites se betonit me nje rezervuar celiku e cila do te instalohet brenda kesaj depozitet dhe do te kete nje kapacitet prej 60m³ Karburanti sherben per furnizimin e mjeteve te subjektit si betoniere dhe presa dhe mjetet e ngarkimit te inerteve.

AUTOSERVISI

Prona ku ndodhet ky aktivitet eshte ne kompleks me gjithë pronen e subjektit dhe eshte i pozicionuar ne Jug-Lindje te objektit.

- Objekti eshte nje pike servisi i cili eshte ne zhvillim e siper ku do te istalohen te gjitha pajisjet dhe celesat e nevojshem te cilat do te merren nga importi.
- Ate do te jene bashkekohore dhe te lehta ne perdorim dhe manovrim. Ne momentin autoservici ka vetem gropen e kontrollit te mjeteve Ne kete objekt do te kete aneks magazine ku do te fumizohen nevojat per ate pjese kembimi qe duhen zevendesuar, por me e rendesishmja do te kete, qe do te sherbeje per zevendesimin e pjeseve te kembimit per motorat e automjeteve subjektit , te cilat gjate kryerjes se sherbimit ne autoservis kerkojne zevendesimin e menjehershem te tyre me pjese te reja. Per te fituar kohe, automjeti merr menjehere pjesen qe i nevojitet dhe sherbimi kryhet mjaft shpejt. Pra do te kete nje oficine autoservisi qe ka per qellim kryerjen e sherbimeve te mirembajtjes dhe riparimeve te motorave te automjeteve te tipeve te ndryshme.

- Do te punoje ne pjesen me te madhe te kohes me nje turn ose edhe me gjate ne varesi te kerkesave.
- Ka te punesuar 2 specialiste te fushes, te afte per te kryer disa lloje sherbimesh perfshire dhe prerjet e metaleve nese do te duhen.

Makinerite dhe pajisjet kryesore do te jene:

- Pajisja e ngritjes se automjeteve(urat) me kapacitet 20ton,
- Elektrongritesa te vegjel me fuqi deri ne 10kW,
- Vegla te ndryshme trapano bangoje, gurzmerilo bangoje, impiante per karikim te baterive,
- Pajisje per heqjen e vajit me vakum dhe derdhjen e vajit te motorrit ne fuci 100 dhe 200 litershe,
- Set veglash dore si trapano, gur zmerilo, set celesash te ndryshem,
- Pajisja per zmontimin e shpejte te gomave etj.
- Te gjitha do te jene me konstruksione tradicionale, te komandimit manual. Pesha totale e te gjitha makinerive dhe pajisjeve teknologjike te marra se bashku do te jete 5 000-10.000kg.
- Te gjitha pajisjet do te vihen ne levizje me ane te energjise elektrike. Fuqia totale e instaluar nuk do ti kaloje 10kW.
- Furnizimi me uje sigurohet edhe nga shpimi i ndodhur prane autoservisit e lavazhos
- Punimi kryesor eshte riparimi i pjeseve xhenerike dhe pjeserisht i motorave , por ne te ardhmen mund te shtohen:
 - Pastrim
 - Riparime xhenerike
 - Riparim tapicerie
 - Riparim e fryrje gomash
 - Ndrim vaj e grasatime te mundeshme
 - Riparime te sistemit elektrik perfshire edhe karikimin e baterive
 - Riparime te sistemit te ngrohjes
 - Zevendesime te motorrinove, dinamove, pompave te ujit, pompave te vajit, etj.
 - Heqja e vajit nga automjetet do te behet duke thither me pajisje me vakum, duke mos lena asnje mundesi qe vaji te derdhet ne mjedis.
 - Per mbrojtjen e mjedisit do te behet qe ne objekt ndarja e mbetjeve sipas rrymave:
 - Mbetje organike
 - Mbetje te biodegradueshme (hotelerike)
 - Mbeturinat plastike.
 - Mbetje leter apo karton.
 - Mbetje te lengeta te hidrokarbureve.



LAVAZHO

- Lavazho është pjesë perberse e kompleksit dhe është vendosur në një pozicion Jug Lindor në një sipërfaqe prej 200m²
- Lavazhua është e ndarë në tre panele dhe e sistemuar me një rrjet perfekt kanalizimesh.
- Furnizimi me ujë i lavazhos bëhet nga një pus shpimi i hapur aty pranë i cili ka një prurje prej 3 l/ në sekonde sasi kjo e mjaftueshme për funksionimin normal të lavazhos.
- Lavazhua është për larjen e automjeteve tip kamjon betoniere presa etj. Kështu që dhe ndotjet janë me të kufizuara .

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Klima:

a) Ererat.

Shpejtesia mes-1.8m/sek

Shpejtesia min.-1.4m/sek

Shpejtesia max.-2.2m/sek

- **Diellezimi:** 2629.3 ore/vit

Dhjetori-113.4 ore(minimumi)

Korriku-354.6 ore(maksimumi)

- **Drejtimi mbizotërues i ererave:**

Dhjetor----Jugu dhe Juglindja

Gjithë viti----- Veriperendimi

b) Temperatura dhe lageshtia e ajrit.

Temperatura mesatare vjetore është 15°C

Në dimër mesatarja arrijn në 5-8 °C

Në pranverë mesatarja arrijn në 12-15 °C

Në verë mesatarja arrijn në 26-29 °C

Në vjeshtë mesatarja arrijn në 13-19 °C

Temperatura më e ulët ka arritur në Janar me -14 °C dhe më e lartë në Gusht rreth 35 °C.

Lageshtia relative është rreth 70%.

c) Rreshjet.

Mesatarja vjetore e renieve te shiut eshte rreth 980mm/vit. Sasia me e madhe e reshjeve arrin ne muajin Nentor ne 170-175 mm dhe me e ulta arrin ne Korrik 40-42 mm. Rreshjet me te larta ne 24 ore arrjne ne 187 mm.

Sipas stineve reshjet shperndahen si me poshte:

Ne dimer rreth 340 mm/vit

Ne pranvere rreth 225mm/vit

Ne vere rreth 90mm/vit

Ne vjeshte rreth 315mm/vit

Ne zonen ku zbatohet projekti klima eshte tipike mesdhetare. Ne ererat e kesaj zone te komunes Kastriot, te rrethit te Dibres, mbizoterojne ato te Veriut dhe me drejtim nga Veri-Perendim per ne Jug-Lindje pergjithesisht duke ndjekur drejtimin e lugines se lumit te Drinit ne bregun e te cilit do te vendoset impianti. Temperatura mesatare vjetore eshte 12°C me tendence rritjeje. Temperatura mesatare me e ulet ka arritur ne Janar -14-18°C dhe me e larta ne Gusht 23-36°C. Lageshtia relative arrin rreth 70-75%. Mesatarja vjetore e reshjeve eshte 966 mm.

Pershkrimi i flores dhe faunes

Ne zonen e afert me linjen e prodhimit te inerteve, flora e eger perfaqesohet nga bimesi e ulet barishte te ndryshme dhe ferra karakteristike te zones te ketij fshati. Ne anen verilindore ndodhen edhe siperfaqe toke kondrinore ku jane te veshura me disa drure e shkurre te ulet si dushk, shkoze etj. Siperfaqja e tokes ku do te vendoset kjo linje nuk ka ndonje status te vecante mbrojtjeje dhe ushtrimi i ketij aktiviteti, nuk ka ndonje ndikim negative ndaj biodiversitetit dhe mjedisit ne pergjithsi. Fauna e eger perfaqesohet nga zogjte si harabeli, gushkuqi, tershila, turtulli, pellumbat e eger, laraska dhe zogj te tjere shtegta redallandyshja, etj. Nder kafshet e egra permendin lepurin, dhelpren, iriqin, breshken. Zona e impiantit ndodhet kryesisht ne nje siperfaqe joproduktive, e rralle me bimesi pyjore dhe ne mes zones bujqesore te fshatit. Nuk mund te themi se eshte demtuar ndonje habitat i rendesishem. Edhe vete impianti frekuentohet sidomos nga shpendet e eger sepse

jo gjithmone makinerite jane ne pune.Megjithate,zhurma e makinerive zbutet pjeserisht nga muri rrethues 2 m i larte dhe stoqet e inerteve qe bejne thyerje te ndjeshme te saj.Zhurma e makinerive bashke me zhurmen e lumit sic duket nuk kane ndonje ndikim te ndjeshem sidomos per zogjte.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Çdo aktivitet qe zhvillohet shoqerohet me pasoja dhe ndikime ne mjedis, qe jane pjese e atij kompromisi qe shoqeria jone ka zgjedhur per tu zhvilluar. Megjithate e rendesishme eshte qe te kuptohet natyra e ketyre proceseve, forma e shfaqjes se tyre dhe me analitikisht ndikimet e cdo operacioni te kryer.

- Shkarkimet dhe mbetjet qe prodhohen

Shkarkimet ne ambient i klasifikojme sipas natyres se tyre:

Shkarkimet ne ajer jane:

Nga impianti i thyerjes-fraksionimit dalin 0.02% pluhura me diameter me te madh se 0-10mm dhe nje sasi shume e vogel pluhura me te imta.

Shkarkimet e lengeta jane:

Ujra te larjes se inerteve ne impiantin e larje fraksionimit te cilat rezultojne me balte(dhera dhe argjila rreth 30%e lendes se pare).Keto ujra filtrohen ne pirgjet e zhavorit ne pjesen e pjerret te impiantit te larjes duke krijuar nje grumbullim balte gjate kohes se punes.

Vajrat e paperdorshme qe mund te rezultojne ne oficinen e riparimit te makinave afersisht mund te llogariten disa litra ne muaj.Ato depozitohen ne nje fuci metalike per riperdorim per qellime te tjera.

Shkarkimet e ngurta:

Dherat e larjes se inerteve qe vijne nga perroi te cilat grumbullohen ne afersi te larje-fraksionimit.Me pas keto dhera largohen dhe perdoren per mbushje dhe sistemim terreni.Ujrat e qarta me pas derdhen ne perroin qe kalon shume prane objektit.

Mbetjet e tjera te perdorimit te perditshem nga aktiviteti i punonjesve, te cilat zene nje volum relativisht te vogel, te te gjithe mbetjeve te ngurta,mblidhen dhe dergohen ne vendshkarkimin e caktuar te mbeturinave prej komunes.

Zhurmat (ose ndotje akustike)

Zhurma maksimale e agregateve te vecante te impiantit perfshihet mes 125 dhe 400 Hz. Kundra efektit te zhurmave ne distance te shkurter jane marre masa te tilla qe operatoret jane vene ne kushte te kondicionimit akustik dhe termik. Ndersa per shmangien e zhurmave ne distance me te largeta jane marre masat qe ne fillim te zgjedhjes te vendit te ndertimit larg qendres se banuar dhe ne pozicion te maskuar te terrenit. Gjithashtu per rreth impiantit do te vendosen grumbuj te medhenj zhavorri te cilet te mbulojne komplet silueten e objektit. Si rezultat i ketyre kushteve zhurma maksimale kundrejt pjeses me te madhe te punonjesve dhe zyrave nukkalon 75dB, ndersa ky efekt per kalimtarete dhe banoret me te afert eshte shume me i zbutur. Paraprakisht para fillimit te investimeve, do te kryhen me pare investime te tilla si rrethimi i te gjithe siperfaqes me mure 2 m te larte me tulla betoni dhe shtrimi, sistemimi i sheshit me zhavor te paster. Do te realizohet nje sistem drenazhimi dhe kullimi perfekt i ujrave te bardha. Gjithashtu nga studimi gjeologjik ka rezultuar se me vendosjen e makinerive te planifikuara ky shesh nuk rreshqet.

4. MASAT PER ELEMENIMIN / ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

MASAT NDAJ EMETIMIT TE GAZEVE

Gjate procesit te punes clirohen tymra dhe avuj uji nga djegia e gazit qe perdoret per tharjen e inerteve dhe gjate nxehtjes se bitumit. Ne keto kushte kur impianti nuk punon ato mbahen bosh dhe nuk jane burim i vazhdueshem rreziku per zjarr ose ndotje te mjedisit nga derdhjet aksidentale ne toke. Gazet e fures nga djegia e gazit para se te dalin ne oxhakun e fures kalojne ne filtrimin e gazeve dhe pluhurit. Ky filter eleminon tymrat ndotese te krijuara nga djegia, kap pluhurat e imeta te inerteve dhe i rikthen ato perseri ne procesin e prodhimit te asfalto-betonit. Ne dalje te fures se tharjes gazet kalojne me aspirim tek seperatori ku dekantojne ne hinke te gjitha grimcat e reres me dimension me te madh se 0.1 mm. Rendimenti kapes eshte 75-85 % dhe per grimca me te medha se 0.1 mm rendimenti kapes eshte 98%. Pluhurat qe nuk kapen nga filtri i tymrave te tharjes perpunohen ne filtrin me mence. Gazi pjesisht i polvirizuar ne dalje te resperatorit thithet nga filtri, volume te cilit provokon zgjerim te konsiderushem te gazit dhe si pasoje renien e shpejtesise se tij. Ne keto kushte pluhurat dekantojne ne fundin e filtrit me mence. Menget filtruse te vendosura ne presion I detyrojne gazet dhe pjesezat me te imta qe akoma gjenden ne suspension te ndalojne ne siperfaqen e menceve prej ku hiqen ne menyre ciklike me anen e futjes se ajrit me presion ne drejtim te kundert. Pluhuri qe shkeputet nga menga bie mbi fundin e filtrit dhe del jashte. Gazet e filtruara futen perseri brenda te thithura nga nje kolektor te vendosur ne mengjen e filtrit.

MBROJTJA NGA ZHURMA

Ndikimi nga zhurmat eshte minimal dhe te pakonsiderueshme per keto arsye:

Ne zonen e objektit nuk ka objekte sociale si shkolla, spitale, etj qe zhurmat e krijuara gjate funksionimit te pajisjeve te shkaktojne probleme. Gjithashtu impanti ndodhet ne nej distance te larget edhe nga zonate banuara. Ato jane te pakonsiderueshme. Punetoret jane te pajisur me mjete mbrojtese ndaj zhurmave

SIGURIMI TEKNIK

Mbrojta e shendetit dhe siguria ne pune jane ne qender te vemendjes te shoqerise. Per te mbajtur nje regjim te forte te sigurise ne pune dhe shendetit te plote te punonjesve do te merren masat e meposhtme:

Punonjesit para fillimit te punes dhe gjate saj ne menyre periodike do te instruktohen per rreziqet ne pune dhe masat e menytrat per parandalimin e tyre.

Do te punesohen punonjes qe e kane mbushur moshen per pune dhe specialiste te profesioneve qe kerkohen.

Do te punesohen punonjes qe kane eksperience te gjate ne profesion.

Masat per mbrojtjen nga zjarri do te jene pjese e instruktiveve e te tabelave lajmeruese e parandaluese.

5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Ndertimi i impiantit te prodhimit te asfalto-betonit , realizon kthimin e nje siperfaqeje te pa shfrytezuar ne siperfaqe te nevojshme dhe ka keto ndikime positive:

Ka punesuar nje numer te konsiderueshem njerezish.

Aktiviteti i impiantit eshte prodhim per asfalto-beton, per shtrimin e rrugeve.Prandaj efektet pozitive te ketij aktiviteti jane te konsiderueshme.

Ky aktivitet nuk do te shkaktoje ndotje te ajrit, tokes, ujit te pijshem dhe ujrave nentokesore, se nuk do te kete shkarkime te ketyre lendeve.

Zona ku eshte ndertuar impianti eshte zone e lire.

Ky aktivitet prodhues nuk demton habitate dhe nuk prish ekuilibrat biologjike-natyrore.

Prodhimi i mbetjeve te ngurta eshte i vogel i pakonsiderueshem dhe do te mbahen nen kontroll dhe trajtimi i tyre do te behet konforme detyrimeve ligjore. Po keshtu clirimi i gazeve dhe pluhrave ne ambjent do te mbahet ne kontroll te rrepte teknik.

PER “EKO-STUDIO-PROJEKT” sh.p.k
Punoi: Msc.Ing.mjedisi Ana Naçi